

ENTI RREGULLATOR I UJIT



SHOQËRIA RAJONALE UK KUKËS

ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022

Tiranë, 2023

Bilanci i Ujit

Analiza e Humbjeve të Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Kukës

I. Të Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht më cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe më qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjelle nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe "Bilancin e Ujit" në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vete për çdo njësi (ish shoqëri UK) që tashmë është nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar dhe më pas analiza behet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihen parasysh në të ardhmen për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.

Kjo analizë i vjen në ndihmë çdo shoqëri rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike me nivelin e humbjeve (UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikave e faturimit më matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

"Bilanci i Ujit" si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA, duhet të hartohet më të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe më qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.

Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjellësve).

Duke patur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit më ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave më Matje të Pavarura (DMA-të), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga "lart-poshtë" (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme, dhe më tej përcaktohen ato reale.

II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Kukës

Shoqëria rajonale UK Kukës u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK, përkatësisht UK Kukës, Tropojë dhe Has. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Kukës jepen në **tabelën 1**.

Nga të dhënat e Tabelës 1, rezulton së probleme të nën faturimit për konsumin aforfe konstatohen pothuaj për çdo njësi. Shoqëritë UK duhet të analizojnë arsyet e nën faturimit aforfe (nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktive), sepse dihet që konsumi mesatar për banor për këtë lloj faturimi referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 duhet të jetë 150 litra/banor në ditë.

Tabela Nr. 1 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh. R. Kukës	Popullsia me shërbim	Konsumi total (në m3)	Konsumi i matur (në m3)	Konsumi pamatur (në m3)	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							(l/ditë, banor)		
Kukës	25,852	1,027,000	247,000	780,000	2,115	4,297	79.4	123.3	108.8
Tropojë	10,066	446,000	391,000	55,000	2950	336	118.5	146.4	121.4
Has	7,165	285,000	190,000	95,000	1,090	416	100.4	131.5	109.0
Shuma	43,083	1,758,000	828,000	930,000	6,155	5,049	95.8	131.2	111.8

Nga ana tjetër, referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në **tabelën 2**, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen burimet ujore respektivë dhe kapacitetet e tyre.

Tabela 2 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh .R. Kukës	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futët në sistem (në m3)	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia* e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Kapaciteti i Burimeve (në m3/vit)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor)
Kukës	25,852	2,566,000	108.8	44,114	2,979,417	185	+76.2
Tropojë	10,066	1,226,000	121.4	17,184	29,561,599	4,713	+4,591.8
Has	7,165	823,700	109.0	10,200	1,123,000	302	+192.7
UK Kukës (Rajonale)	43,083	4,615,700	111.8	71,498	33,664,016	1290	+1178.2

* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023 ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë për llogaritje shërbeu mbulimi me shërbim i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2 shihet se shoqëria rajonale UK Kukës ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit, gjithsesi në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja dhe shfrytëzimi me efikasitet i burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas Kërkesës për Ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse, për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të FU në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

II.1 UPA për Ish Shoqërinë UK Kukës

Për vitin 2022, shoqëria UK Kukës ka raportuar se prodhimi vjetor që hyn në sistemet e furnizimit prej 2,566,000 m3 është **100% i vlerësuar** ujë pasi mungojnë matësat në burim. Për shërbimin e furnizimit me ujë raportohen 7,184 lidhje ndërsa shërbimi me furnizimin me ujë ofrohet për rreth 58.6% të popullsisë në juridiksion.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhojë monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas çdo zone DMA, gjë e cila e vështirëson monitorimin efikas të humbjeve duke u orientuar me prioritet strategjinë për zvogëlimin e tyre në DMA-të më problematike.

“UPA” 49.40% e prodhimit, rezulton në nivele të pakënaqshme. Niveli i matjes për konsumin e faturuar është rreth 33% pasi vetëm 2,692 lidhje uji janë të pajisur me matës.

Në tabelën 3 paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Kukës.

Tabela 3. Bilancit i Ujit për Ish Shoqërinë Kukës - Viti 2022.

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	2,566,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	423,741	16.51%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	874,625	34.09%
Faturimi total	1,298,366	50.60%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	7,000	0.27%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	220,000	8.57%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës	49,268	1.92%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	205,000	7.99%
Humbjet e dukshme (administrative)	474,268	18.48%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	185,000	7.21%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	57,680	2.25%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet e derdhjet në depot e ujit	50,000	1.95%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	483,686	18.85%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	10,000	0.39%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	786,366	30.65%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	1,260,634	49.13%
UJI PA TË ARDHURA	1,267,634	49.40%

Komente :

- UPA në nivelin 49.40% të prodhimit vjetor, konsiderohet si performancë e dobët.
- Volumi i ujit të prodhuar nuk matet. Kjo mund të jetë dhe shkak kryesor i diferencës mjaft të madhe ndërmjet volumit të ujit të prodhuar ndaj atij të faturuar. Në bilancin e ujit pasaktësia gjatë vlerësimit të volumeve është vlerësuar në nivelin 7.99% të prodhimit.
- Niveli i humbjeve reale në linjat e transmetimit (7.21%) si dhe humbjet e shkaktuara nga lidhjet e paligjshme (8.57%) në këto linja, konsiderohen mjaft të larta. Për këtë shoqëria duhet të verifikojë nëse ekzistojnë të regjistruara në evidenca, të cilat vërtetojnë çarje mjaft të shpeshta të linjave të transmisionit, si dhe të hartojë plan veprimet për zbulimin e lidhjeve të paligjshme.
- Nevoja për ujëmatës individual është e dukshme, vetëm 34.5% e klientëve janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa e mbetur faturohet aforfe.

Rekomandime:

- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndër marrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore.*
- *Të thellohet në analizën për të përcaktuar së ku ekziston saktësisht problematika me ujin e faturuar aforfe, si dhe të kontrollohet puna e lexuesve të matësive, për të verifikuar se si ato faturojnë aforfe dhe se sa është numri i banorëve për çdo lidhje bazuar në certifikatën familjare të vitit aktual.*
- *Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar që përcaktohet me vlerësim, që të gjitha burimet të pajisen me matës prodhimi si element kyç për hartimin e bilancit të ujit*

- Për humbjet reale të larta në linjat e transmetimit, nëse janë probleme evidente të gjendjes së keqe fizike të tyre, urgjentisht të planifikohen fonde nga qeveria qendrore ose me fondet e veta për riparimin e tyre.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mire të humbjeve, diagnostifikimin e tyre, si dhe hartimin e planeve të masave për zvogëlimin e tyre.

II.2 UPA për Ish Shoqërinë UK Tropojë

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Tropojë ofrohet për 59% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor 1,226,000m³ ujë është 100% i vlerësuar sepse mungojne matesat ne burim.

Numri i lidhjeve me ujë raportohet 3,646 lidhje nga të cilat 3,249 lidhje faturohen me konsum të matur ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe.

Faturimi i realizuar rezulton në nivelin 43.64% të prodhimit.

“Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 56.36%.

Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve. Nevoja për trajnim të stafit “mbi humbjet e ujit” është e domosdoshme.

Në Tabelën 4 paraqitën komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Tropojë.

Tabela 4. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Tropojë– Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	1,226,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	456,000	37.19%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	79,000	6.44%
Faturimi total	535,000	43.64%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	20,730	1.69%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	117,470	9.58%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës	89,830	7.33%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	110,560	9.02%
Humbjet e dukshme (administrative)	317,860	25.93%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	88,370	7.21%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	27,640	2.25%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet e derdhjet në depot e ujit	29,100	2.37%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	198,200	16.17%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësllësit	9,100	0.74%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	352,410	28.74%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	670,270	54.67%
UJI PA TË ARDHURA	691,000	56.36%

Komente :

- Treguesi i UPA prej 56,36% rezulton në nivele të pakënaqshme.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar me vlerësim (për 100% i vlerësuar), mund të jetë shkak kryesor i diferencës mjaft të madhe ndërmjet volumit të ujit të prodhuar ndaj atij të faturuar.

- Humbjet e shkaktuara nga Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar i Ujit janë 1.69% e prodhimit vjetor, rezultuan mbi normat e lejuara.
- Humbjet administrative në nivelin 25.93% të prodhimit shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në linjat e transmetimit (9.58%), shpërndarje (7.33%) si dhe nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturimet, (9.02%) etj. Këto humbje konsiderohen mjaft të larta sidomos ato në linjat e transmetimit.
- Humbjet teknike në nivelin 28.74% konsiderohen të larta dhe rezultojnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës (16.17%) dhe atë të transmetimit (7.21%). Këto të fundit janë veçanërisht të papranueshme, për të cilat shoqëria duhet të japë argumenta për praninë e tyre në këto vlera.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që asnjë burim i shfrytëzueshëm nuk është i pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediatë. Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, diagnostifikimin dhe hartimin e planeve të masave për zvogëlimin e tyre.*
- *Rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet gjithashtu trajnimit të vazhdueshëm të stafit teknik në këtë fushë.*

II.3 UPA për Ish Shoqërinë UK Has

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Has ofrohet për 70.2% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor në sasinë 823,700 m³, **raportohet i matur në nivelin 86.4%**, pjesa tjetër vlerësohet bazuar në kapacitetin e depove të ujit.

Nga raportimi i të dhënave, faturimi total rezultoi në nivelin 41.48% e prodhimit. Numri i klientëve për shërbimin e furnizimit me ujë është 1650 klientë, prej të cilëve 1250 janë të pajisur me aparate ujëmatës.

“Uji Pa të Ardhura” rezultoi në nivel të pakënaqshëm (58.52%).

Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në baze të DMA-ve. Stafi teknik paraqet nevojën për trajnim mbi “humbjet e ujit”, pranë institucioneve që ofrojnë këto trajnime, si SHUKALB etj.

Në Tabelën 5 paraqitën komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Has mbi të cilat bazohet analiza e humbjeve të ujit .

Tabela 5. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Has – Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	823,700	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	244,330	29.66%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	97,370	11.82%
Faturimi total	341,700	41.48%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	30,000	3.64%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	50,000	6.07%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës	85,000	10.32%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	63,000	7.65%
Humbjet e dukshme (administrative)	198,000	24.04%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	55,000	6.68%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	24,000	2.91%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet e derdhjet në depot e ujit	25,000	3.04%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	145,000	17.60%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësllësit	5,000	0.61%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	254,000	30.84%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	452,000	54.87%
UJI PA TË ARDHURA	482,000	58.52%

Komente :

- Treguesi i UPA në nivelin **58.52%** konsiderohet i papranueshëm. Gjithsesi, vërtetësia e nivelit të UPA duhet marrë me rezervë pasi nuk kemi prodhim dhe konsum të matur në nivelin 100%. Shoqëria vlerëson se, pasaktësia në matje për volumet e prodhuara e të nën faturuara, është në nivelin 7.65% të prodhimit.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit dhe aktualisht formati i dhënave për bilancin e ujit është plotësuar me mjaft vështirësi nga stafi i shoqërisë.
- Humbjet administrative përbëjnë 24% të prodhimit, prezenca e lidhjeve të paligjshme në transmetim(6.07%) dhe shpërndarje(10.32%) përfaqëson 68% e humbjeve administrative.
- Humbjet teknike në nivelin 30.84% të prodhimit vjetor konsiderohen në nivele të larta, ku 17.60% e prodhimit humbet në rrjetin shpërndarës dhe 6.68% në linjat e transmetimit. Sidomos konsiderohen të larta këto të fundit.
- Konsumi total (41.48%) faturohet me matje në nivelin 71.5% të tij ndërsa Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar (3.64%) konsiderohet në nivele të pakënaqshme.

Rekomandime:

- Duke patur parasysh që 70.2% e prodhimit matet, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim mbetet e nevojshme. Për këtë shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.
- Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjarë me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, që të bëjë të mundur minimizimin e humbjeve të dukshme nga lidhjet e paligjshme.
- Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi

përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.

- Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndër marrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësorë kryesisht në zonat rurale.
- Shoqëria të shohë si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, diagnostifikimin dhe hartimin e planeve të masave për zvogëlimin e tyre.

III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Kukës

Shoqëria Rajonale UK Kukës, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Kukës, Tropojë dhe Has ofron shërbimin e furnizimit me ujë vetëm për **60%** të popullsisë totale.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 12,480 lidhje, nga të cilat 7191 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor **4,615,700 m³ rezulton i matur në nivelin 15%**, nevoja për aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është imediate për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 52.88% të ujit që hyn në sistem.

Shoqëria faturon vetëm **2,175,066 m³ ujë** ose **47.12%** të prodhimit.

Tabela 6 paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Kukës.

Tabela 6. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Kukës – Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem	4,615,700	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	1,124,071	24.35%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,050,995	22.77%
Faturimi total	2,175,066	47.12%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	57,730	1.25%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	387,470	8.39%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës	224,098	4.86%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	378,560	8.20%
Humbjet e dukshme (administrative)	990,128	21.45%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	328,370	7.11%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	109,320	2.37%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet e derdhjet në depot e ujit	104,100	2.26%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	826,886	17.91%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	24,100	0.52%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,392,776	30.17%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	2,382,904	51.63%
UJI PA TË ARDHURA	2,440,634	52.88%

Komente :

- Treguesi UPA në nivelin 52.88% të prodhimit vjetor, konsiderohet i dobët që duhet përmirësuar sa më shpejt.

- Niveli i matjes së “Ujit të Prodhuar” në vlerën 15% i bën të pabesueshme vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit, duke filluar që nga vlera e pasaktësisë në matje prej 8,2% të prodhimit vjetor.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarjes (4.86%) dhe të transmetimit (8.39%) nuk mund të konsiderohen të besueshme deri sa ato të verifikohen në terren nëpërmjet një ekipi të ngritur për këtë qëllim.
- Në humbjet teknike vlera prej 7.11% e prodhimit vjetor nga rrjedhjet në linjat e transmetimit konsiderohen mjaft e lartë prandaj duhen dhënë argumenta të mëtejshme për justifikimin e tyre.
- Konsumatorët familjarë me matje përbëjnë rreth 57.6% të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të Kërkesës për Ujë ky tregues kërkohet të jetë sa me afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi nga stafi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit për të gjitha njësitë, nga ku trajnimi i tij mbi “humbjet e ujit” është i domosdoshëm.

Rekomandime:

- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të trajnojnë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojnë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit për të gjithë zonën e shërbimit.*
- *Nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjarë me matës që ky tregues të jetë sa me afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, ku prioriteti të jepet instalimit të tyre në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Për praninë e lidhjeve të paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktë bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHEE-së.*
- *Të ngrihet një Task Forcë e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësve dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujë nën faturuar.*
- *Të krijojnë dhe të mirëmbajnë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohet.*
- *Për korrigjimin e normave të faturimit me matje, shoqëria duhet të angazhohet në gjetjen e lidhjeve dyfishe. Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet*

faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.

- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese.*